



REPUBLIKA E KOSOVES
KOMUNA LIPLJAN
REPUBLIC OF KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar me: Primitje: 25.04.2025		
Njesia Jednica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
01-052/01-21238		



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVA

KOMUNA E LIPLJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPLJAN

ZYRA E KRYETARIT

Datë:	25.04.2025
Referencë:	
Për:	Imri Ahmeti – Kryetar i Komunës së Lipjanit Daut Azemi – Kryesues i Kuvendit të Komunës së Lipjanit
Kopje:	Diamant Bytyqi – Nënkyetar i Komunës Lulzim Qerimi – Nënkyetar i Komunës
Nga:	Komisioni për hartimin e Rregullores në bashkëpunim me Zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit.
Lënda:	Raport nga procesi i konsultimit publik Draft Strategjia 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027

Hyrje

Në mbështetje të neneve 13, 58 dhe 68 par 68.4 të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr.03/L-040, Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.28 të datës 4 qershor 2008, neneve 40, 41 dhe 67 të Statutit të Komunës së Lipjanit 15Nr.110-78095 i datës 24.12.2021, Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna, Rregullores mbi Transparencën në Komunën e Lipjanit Nr. 15-016/0163314, e datës 26.12.2024 si dhe Planit të Veprimit për transparencë në komunë, Komuna e Lipjanit harton Raport nga procesi i konsultimit publik Draft Strategjia 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027.

Me qëllim të nxitjes dhe sigurimit të pjesëmarrjes së qytetarëve dhe palëve të tjera gjatë procesit të politik bërjes dhe vendimmarrjes së Kuvendit të Komunës së Lipjanit, Komisioni për hartimin e draft- Strategjisë 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 së bashku me zyrtarin përgjegjës për menaxhimin me Platformen e Konsultimeve Publike dhe Koordinimin e zbatimin e konsultimit publik në Komunën e Lipjanit kanë shpallur në:

KONSULTIM PUBLIK

Draft Strategjia 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027

Njoftimit i është bashkangjitur edhe linku i konsultimeve publike dhe linku i platformes për konsultime publike të Qeverisë së Kosovës, ku ka qenë në diskutim publik ky dokument si edhe informatë shtesë se kujt i adresohen komentet.

Shih linqet:

<https://lipjan.rks-gov.net/dokumentet-ne-konsultim-publik/>

<https://konsultimet.rks-gov.net/viewConsult.php?ConsultationID=42787>

Ecuria e Procesit

Komisioni për hartimin e Statutit në bazë të ligjit për Vetëqeverisje Lokale dhe dispozitatat e Udhëzimi administrativ UA Nr.04/2023 për administratë të hapur në komuna. Në bashkëpunim me kordinatorin për konsultime publike kanë publikur në web faqen e komunës njoftimin me datë 21.03.2025 për mbajtjen e konsultimit-debatit publik për Draft Strategjia 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027.

në linkun:

<https://lipjan.rks-gov.net/wp-content/uploads/2025/03/Njoftimi-per-debat-publik-nga-kultura-shqip.pdf>

Ndërsa takimi konsultativ-debati është realizuar në kohën e paraparë dhe me dt. 01.04.2025 është mbajtur në sallën e Kuvendit të Komunës së Lipjanit duke filluar nga ora ora 10:00

Lajmin për mbajtjen e konsultimit mund të gjeni të publikuar në vegëzën:

Linku: <https://lipjan.rks-gov.net/news/ne-sallen-e-kuvendit-te-komunes-se-lipjanit-gjate-dites-se-sotme-eshte-mbajtur-debat-i-hapur-publik-me-qytetare-per-te-diskutuar-draft-strategjine-per-zhvillimin-dhe-fuqizimin-e-rinise-ne-kom/>

Zyrtari për Rini nga drejtorati i kulturës, rinisë dhe sportit z.Bekim Zaskoku si autorizues i kryesues së grupit punues hapi takimin dhe prezantoi para të pranishmëve këtë draft-strategjinë që bazohet në kuadër të strategjisë nacionale për Strategjinë e Kosovës për Rininë 2024-2032. Ky plan dhe strategji ndikon në të mirën e komunitetit gjithpërfshirës, dhe rininë e komunës së Lipjanit, kështu duke qenë të planifikuar vitet në vijim mbi aktivitetet dhe objektivat kryesore.

Para të pranishmëve është prezantuar komisionin në përbërje:

Anila reça Llugiqi, Drejtore e Kulturës, Rinisë dhe Sportit, kryesuese
Bekim Zaskoku, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar,
Uran Qeriqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtar
Pranvera Krasniqi, Drejtorati për Kulturë, Rini dhe Sport, anëtare,
Hasan Luma, NJDNJ dhe barazi gjinore anëtar,
Suzana Mehmeti, Qendra për punë sociale, anëtare
Valdete Muji, Sektori për përfaqësim dhe çështje ligjore, anëtare
Abedin Bajrami, Drejtorati për Ekonomi dhe Zhvillim, anëtar
Brahim Duriqi, Drejtorati për Arsim, anëtar
Arbresha Hetemi, Zyra Lokale për Komunitete, anëtare
Albulena Salihu, Drejtorati për Buxhet dhe Financa, anëtare
Bekim Krasniqi, OJQ “YAHR”, anëtar
Florim Budakova, Shoqata e Pedagogëve të Sportit Shkollor, anëtar

Duke i falenderuar anëtarët për kontributin e tyre në hartimin e këtij Plani z.Bekim Zaskoku ka vazhduar prezantimin duke përmendur edhe qëllimin e pëgjithshëm të strategjisë është të kontribuojë fuqizimin dhe zhvillimin e të rinjve në Komunën e Lipjan. Dokumenti ka për qëllim të ofrojë mundësi trajnimi dhe zhvillim personal për të rinjtë, duke i përgatitur ata të bëhen qytetar aktiv dhe produktiv në shoqëri

Disa nga aspektet kyçe që do të përfshihen në strategji janë:

- Zhvillimi i arsimit jo-formal dhe aftësive,
- Forcimi i komponentës së vullnetarizmit,
- Teknologjia, inovacioni dhe ndërmarrësia rinore,
- Pjesëmarrja e të rinjve në vendimmarrje dhe në politikat lokale,
- Mirëqenia, shëndeti mendor dhe siguria e të rinjve,
- Kultura, arti, sporti dhe aktiviteti fizik,
- Mbrojtja e mjedisit dhe promovimi i ekonomisë së gjelbërt,
- Mbështetja për të rinjtë me aftësi të kufizuara,
- Mbështetja për të rinjtë nga grupet e tjera të marginalizuara

Por njëkohësisht ka theksuar edhe implikimet buxhetore që mund të ketë kjo Strategji dhe Plan në monitorimin e këtij dokumenti.



Konsultimi publik u zhvillua në prezencën e një numër të konsideruar të pjesëmarrësve me qëllim që t'i ofroj publikut qasje të lehtë në mbikëqyrjen dhe zbatimin e politikave nga organet e komunës si dhe rritjen e mundësive të pjesëmarrjes së qytetarëve në proceset vendimarrëse.

Nga ana tjetër të pranishmit paten rastin të inkuadrohen në debat dhe të japin kontributin e tyre për të kompletuar këtë dokument të rëndësishëm.

Komentet nga debati konsultativ lidhur Draft Strategjia 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027

Temat e konsultimit	komentet	Kush ka komentuar	Pergjegja ne pyetje komente	Komenbtet (i pranimi i pjeseshem dhe mos pranimi)
Draft Strategjia 2025-2030 dhe	Ka përgëzuar punën e grupit	Leotrim Pajaziti nga	Komisioni ka theksuar se pjesë	Komenti u pranua plotësisht

Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027	punues dhe të këtij drafti dhe njëherit ka propozuar që si pike tjetër të jetë edhe parandalimi i ekstremizmit të dhunshëm si dhe rritjen e lexueshmërisë tek të rinjtë.	OJQ “ Vizioni Rinor i Shalë ”	e këtij Plani do të jenë edhe këto propozime.	
Draft Strategjia 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027	Ka kërkuar që jenë të përfshira edhe pika shtesë të lidhura me inkurajimin e të rinjëve për pjesëmarrje në aktivitete vullnetare.	Diart Salihu-aktivist rinor	Komisioni -ka potencuar se ky koment do të përfshihet në këtë document lidhur me inkurajimin e të rinjëve për pjesëmarrje në aktivitete vullnetare.	Komenti u pranua plotësisht
Draft Strategjia 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027	Përgëzon punën e komisionit dhe rekomandon pikat ligjore të cilat duhet të cekën si reference në këtë draft.	Kimete Jashanica OSCE-	Komisioni ka pranuar komentën duke theksuar se së bashku me zyren ligjore do të harmonizojnë pjesën ligjore e cila është në fuqi.	Komenti u pranua plotësisht
Draft Strategjia 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027	Falenderon dhe përgëzon punën për punimin e kësaj Draft-strategjie. Propozon që së bashku me DKRS dhe shkollat të mbahen më shumë orë letrare tek të rinjtë në mënyrë që të	Avni Jashari-Shef i Kabinetit të Zyrës së Kryetarit-	Komisioni ka pranuar komentën duke theksuar se në këtë plan di ti kushtohet vëmendje edhe inkurajimit të të rinjëve rreth leximit.	Komenti u pranua plotësisht

	inkurajohen edhe më shumë rreth shkrimit e leximit.			
Draft Strategjia 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027	Përgëzon punën dhe shpreh bashkëpunimin në mes organizatave dhe Drejtoratit, kështu duke orientu projektet që kanë të bëjë me lexim, nxitjen e leximit për vetëdijesim së bashku me punën e organizatave.	Lorik Bërbatovci-Shef për kulturë	Komisioni ka pranuar komentin duke theksuar se në këtë plan di ti kushtohet vëmendje edhe inkurajimit të rinjëve rreth leximit.	Komenti u pranua plotësisht
Draft Strategjia 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027	Përhëndet punën e grupit punues për këtë draft-strategji, duke kërkuar që në kë plan të përfshihen sa më shumë aktivitetet e vullnetarizmit tek të rinjtë.	Bekim Krasniqi-YAHR	Komisioni-ka potencuar se do të jetë e përfshirë në këtë document edhe inkurajimi të rinjëve për pjesëmarrje në aktivitete vullnetare.	Komenti u pranua plotësisht
Draft Strategjia 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027	Përgëzon strategjinë e punuar nga grupi punues, dhe propozon futjen e turizmit, eskurzionet ndaj monumenteve tona që i kemi..	Fadil Krasniqi-Zyrtar për Kulturë-	Komisioni-ka thënë se se në këtë plan do të jetë e përfshirë në këtë edhe pjesa e turizmit.	Komenti u pranua plotësisht

Gjatë fazës së diskutimit publik lidhur me Draft Strategjinë 2025-2030 dhe Draft Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027 Komisioni për hartimin e saj ka shqyrtuar me kujdes të gjitha rekomandimet e pranuar nga palët e interesuara

Takimi filloi në orën 10:00 dhe mbaroi në ora 11:15

Metodat e Konsultimit	Datat/kohëzgjatja	Numri i pjesëmarrësve/konsultimin publik-kontribuesve
15-30 ditë pranohen komentet		17
15-30 ditë		

Në këtë takim konsultativ kanë marrë pjesë 17 pjesëmarrës, prej tyre femra 5 dhe 12 meshkuj.

Bukurie Zejnullahu-Jashari
Zyrtare përgjegjëse për kordinimin e konsultimeve publike



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

Lista e pjesëmarrësve për Debatin Publik për Draft – Strategjinë për zhvillimin dhe fuqizimin e rinisë në Komunën e Lipjanit 2025-2030 dhe Planin e Veprimit Rinor Lokal 2025-2027.

NR.	Emri dhe mbiemri	Nenshkrimi
1	AVNI JASHARI	
2	Pranvera Krasniqi	
3	ARBESH HETEMI	
4	URAN QERIQI	
5	Fatmir Krasniqi	
6	Mërgim Oruçi	
7	Ramir Gashi	
8	LOK BËRBATORCI	
9	Kimete Tashanica OSCE	
10	Bekim Krasniqi	
11	Art Krasniqi	
12	Diart Selihu	
13	Luftim Bajaziti	
14	Bjir Bukur Bajaziti	
15	Besart Jashari	
16	Ferdion Shk	
17	Gaferr Hetemi	
18		
19		
20		
21		